



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS PËR VITIN 2021

Prishtinë, qershor 2022

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Mamushës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Mamushës (KM), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Mamushës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 Çështja që kanë ndikuar në opinionin e auditimit ishte pasi Komuna nuk kishte regjistruar vlerën e pasurive 85,207€ në regjistrin e pasuritë mbi 1,000€ në SIMFK si dhe pronat Kadastrale.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Mamushës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

Gjatë angazhimit tonë kemi gjetur se Komuna nuk ka vepruar në pajtueshmëri me autoritetet si:

A1 Komuna kishte paguar me vonesë 5 pagesa në vlerë 99,210€ pas afatit të lejuar prej 30 ditësh.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Mamushës.

## Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Mamushës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Mamushës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Mamushës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Mamushës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë të bëjnë me mos regjistrimin e pasurive mbi 1,000€ në SIMKF, vonesave në pagesë, pagesave në avanse nga mallrat dhe shërbimet, zotimit dhe urdhërblejeve me vonesë, dobësive raportimin e pasurive nën 1,000€ si dhe mos sigurimi i shërbimit të auditimit të brendshëm. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me gjashtë rekomandime, prej tyre katër rekomandime të reja dhe dy të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja B1 - Dobësi në menaxhimin e pasurisë

##### Gjetja

Sipas nenit 6 paragrafi 3 i rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore përcakton që - pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin "e-pasuria".

Komuna nuk kishte arritur ta regjistroj vlerën e pasurive 85,207€ në regjistrin e pasuritë mbi 1,000€ në SIMFK, si në vijim:

- Autobusin në vlerë 48,467€ të pranuar donacion nga Turqia;
- Furnizimet me pajisje mjekësore moderne për QKMF Mamushë në vlerë 19,290€ (e financuar nga IOM 11,290€ dhe komuna 8,000€);
- Rregullimi i rrugës fushore dhe renovimi i parkut të qytetit në komunën e Mamushës në vlerë 17,450€; dhe

Kjo gjendje është rezultat i mungesës së kontrollit të brendshëm që pasuritë të regjistrohen në SIMFK.

##### Ndikimi

Mos regjistrimi i aseteve të blera apo pranuar si donacione ndikon në nënvlerësim të regjistrin të pasurive dhe nga kjo rrjedhimisht ndikon që informatat e paraqitura në PVF të mos jenë të sakta.

##### Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë se është vendosur një proces efektiv i regjistrimit të pasurisë në mënyrë që regjistrat të jenë të plotë dhe të paraqesin informata të sakta me qëllim të raportimit të drejt dhe menaxhimit adekuat të pasurisë që Komuna ka në posedim.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A1 - Vonesa në pagesa

**Gjetja** Sipas nenit 39.1 të Ligjit nr. 03 /L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, kërkohet që secila faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë të mallrave dhe shërbimeve të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas marrjes së faturës.

Gjatë testimit, ne kemi vërejtur në 5 fatura në vlerë prej 99,210€, që faturat nuk ishin paguar brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. Vonesat ishin deri në 3 muaj.

Mos pagesa e faturave brenda afatit të paraparë ligjor ishte për shkak të mos sigurimit të fondeve buxhetore për pagimin e shpenzimeve me kohë.

**Ndikimi** Vonesat në pagesën e obligimeve rrit rrezikun për shpenzime shtesë gjyqësore apo të përmbarimit.

**Rekomandimi A1** Kryetari duhet të siguroj funksionimin efikas të pikës së kontrollit që verifikon se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me ligj.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)



## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2021 ishte 330,143€, prej tyre ishin shpenzuar 324,150€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shërbime kontraktuese tjera, pajisje, derivate, avanse, pagesa për bashkëfinancime, shpenzime për zyrë, shpenzime për tel etj. Kemi testuar 17 mostra për teste substanciale dhe të pajtueshmërisë në vlerë 136,959€ si dhe procedura të prokurimit.

#### Çështja A2 - Pagesat në avanse nga mallrat dhe shërbimet

**Gjetja** Ligji i Buxhetit Nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2020, neni 14 Pagesat e paradhënies pika 1, citon që, Organizatat buxhetore mund të paguajnë paradhënie kontraktuesve për projektet kapitale dhe për mallra dhe shërbime deri në pesëmbëdhjetë për qind (15%) të vlerës së kontratës. Pagesa e tillë e paradhënies mund të bëhet vetëm në bazë të kontratës së lidhur në mënyrë ligjore, me vlerë më të lartë se dhjetëmijë (10,000) euro, e cila është arritur në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik.

Komuna me datën 04.10.2021 kishte nënshkruar një marrëveshje për bashkëpunim dhe bashkëfinancim me titull "Shëndet dhe mirëdheqenie sociale për të gjithë" në vlerë 253,596€. Komuna kishte obligim të participoj vlerën 207,636€ ndërsa pjesën tjetër 45,960€ nga OJQ. Sipas marrëveshjes periudha e implementimit të saj fillon nga 01.11.2021 deri 31.10.2022, e cila kishte cituar që pjesa e mjeteve të komunës fillon të transferohet pas nënshkrimit të marrëveshjes.

Megjithatë, ne kemi vërejtur që pagesat e avanseve prej mallrave nuk ishin bërë siç kërkohet me ligjin e buxhetit të vitit 2021. Në tetor të vitit 2021, komuna kishte paguar 3 avanse në vlerë 96,349€.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme që pagesat të mos bëhen në avanse siç parashihet me ligj.

**Ndikimi** Pagesat në paradhëniet përveç që janë në kundërshtim me ligjin e buxhetit, mund të ndikojnë që shërbimet mos të kryhen sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshje.

**Rekomandimi A2** Kryetari duhet të siguroj funksionimin efikas të pikës së kontrollit që verifikon se pagesat/avanset bëhen në përputhje me përqindjet përcaktuara me ligj të buxhetit.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.3.2 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike si psh: mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

### Çështja A3 - Zotimi dhe urdhërblerja me vonesë

#### Gjetja

Rregulla financiare Nr.01/2013, neni 22, përcakton hapat për procedim të pagesave, ku fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje (zotimi i mjeteve), të procedohet urdhërblerja, pastaj pranimi i mallit, pastaj pas pranimi të faturës të ekzekutohet pagesa.

Gjatë testimi në 4 pagesa në vlerë 71,844€ kemi vërejtur që zotimi dhe urdhërblerja ishin lëshuar pas pranimi të faturave. Këto raste janë si më poshtë:

- Në 2 pagesa në vlerë 14,049€ zotimi dhe urdhërblerjet ishin nxjerrur pas pranimi të faturës; dhe
- Në 2 pagesa në vlerë 57,795€ urdhërblerja ishte nxjerrur pas pranimi të faturës.

Kjo ka ndodh si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efikase në procesin e menaxhimit dhe ekzekutimit të pagesave.

#### Ndikimi

Zotimi i mjeteve financiare dhe procedimi i urdhërblerjeve me vonesë vështirëson zbatimin e drejtë të kontratave dhe krijon paqartësi rreth urdhëresave për furnizim, shërbime apo fillim të punëve.

#### Rekomandimi A3

Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që procesi i ekzekutimit të pagesave të bëhet në harmoni me rregullat financiare për shpenzimin e parave publike.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 1,227,291€, pasurive jokapitale është 75,132€, si dhe e stoqeve ishin 40,039€. Kemi testuar 20 mostra për teste substanciale të pajtueshmërisë në vlerë 301,972€.

#### Çështja A4 - Dobësi në raportimin e pasurisë nën 1,000€

**Gjetja** Sipas nenit 24 pika 2.2 e rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore përcaktohet që paraqitja në pasqyrat vjetore financiare duhet të bëhet nga e-pasuria për pasuritë me vlerë nën 1,000€ dhe afat të përdorimit mbi një vit dhe stoqet dhe nenit 3 ku paraqitja e pasurisë jo financiare në pasqyrat financiare vjetore do të prezantohet në bazë të vlerës kontabël neto.

Gjatë vitit 2021, Komuna në PFV kishte prezantuar pasurinë nën 1,000€ në vlerë 75,132€ nga raporti i pranimit të mallit, për dallim që vitin e kaluar vlera e prezantuar ishte 9,774€. Kjo rritje tregon që, ky raport përfshinë edhe materialin shpenzues si dhe nuk prezanton shpenzimet e zhvlerësimit.

Kjo ka ndodhur për arsye të mos azhurnimit të të dhënave me arsyetimin që nuk kishte kontratë për mirëmbajtje të sistemit e-pasuria nga MAP/MPB.

**Ndikimi** Prezentimi i pasurive nën 1,000€ në PFV nga raporti i pranimit të mallit duke mos përllogaritur zhvlerësimin si dhe duke përfshirë edhe materialin shpenzues reflekton me prezantim jo të drejtë të pasurisë në PFV, duke e mbivlerësuar vlerën e tyre.

**Rekomandimi A4** Kryetari duhet të sigurojë se vlera e pasurisë nën 1,000€ në PFV prezantohet në bazë të vlerës kontabël neto në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.4 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Komuna nuk i plotëson kriteret për themelimin e NjAB. Komuna me dt. 05.10.2021 kishte parashtruar kërkesë për auditim të brendshëm drejtuar Njësisë për Auditim të Brendshëm në kuadër të Ministrisë së Financave.

#### Çështja B2 - Mos sigurimi i shërbimit të auditimit të brendshëm

**Gjetja** Ligji nr. 06 / L-021 për Kontrollin e brendshëm të financave publike dhe Rregulloren e QRK-së nr. 01/2019 për krijimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, nenet 4 dhe 5 përcaktojnë funksionin dhe mënyrën e themelimit të NJAB-së. Bazuar në nenin 5 " Subjekti i sektorit publik i cili ka buxhet më pak se tre (3.000.000€) milionë euro, funksionin e auditimit të brendshëm ta ushtron përmes mënyrave tjera sipas nën paragrafëve 1.2, 1.3. dhe 1,4 të nenit 4 të kësaj Rregulloreje. (themelimin e një njësi të përbashkët, apo marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të auditimit nga një subjekt i sektorit publik apo kontraktimit të një kompanie profesionale sipas kriterëve të vendosura, me miratimin/ aprovimin paraprak të MF).

Komuna gjatë vitit 2021 nuk ishte audituar edhe pse e ka dërguar një kërkesë në MF me dt. 05.10.2021 për nevojat e shërbimit të auditimit të brendshëm. Lidhur me këtë komuna edhe për vitin 2020 kishte bërë kërkesë, mirëpo nuk kishte arritur të siguronte raport të auditimit të brendshëm.

Kjo për shkak se nuk janë bërë përpjekje për themelimin e një njësi të përbashkët, apo marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të auditimit nga një subjekt i sektorit publik apo kontraktimit të një kompanie profesionale sipas kriterëve të vendosura, miratimit/ aprovimit paraprak të MF.

**Ndikimi** Mungesa e raporteve të auditimit të brendshëm shpie në përsëritjen e vazhdueshme të dobësive në sistemet kryesore të kontrollit të brendshëm dhe menaxhmenti mund të mos jetë në gjendje të identifikojë dobësitë e kontrollit dhe të përgjigjet në kohën e duhur për t'i eliminuar ato.

**Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurojë shërbimin e auditimit të brendshëm, që synon shtimin e vlerës dhe përmirësimin e funksionimit të Komunës, që ndihmon në përmbushjen e objektivave, duke ofruar qasje sistematike, të disiplinuar, për të vlerësuar dhe përmirësuar efektshmërinë e proceseve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>4</sup>	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>1,706,403</b>	<b>1,763,942</b>	<b>1,719,525</b>	<b>2,187,392</b>	<b>1,966,586</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	1,649,469	1,650,127	1,637,017	2,100,288	1,880,386
Financimi përmes huamarrjes	0	10,328	10,178	22,707	0
Të bartura nga viti i kaluar	0	46,445	46,445	32,094	59,844
Të hyrat vetanake	56,934	56,934	25,777	21,043	25,969
Donacionet vendore	0	0	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	108	108	11,261	387

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 57,539€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga vitit i kaluar, financimi nga huamarrja dhe donacioneve

Në vitin 2021, Komuna ka shpenzuar 97% të buxhetit përfundimtar ose 1,719,525€, me një përmirësim 4% në krahasim me vitin 2020. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të pakënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>1,706,403</b>	<b>1,763,942</b>	<b>1,719,525</b>	<b>2,187,392</b>	<b>1,966,586</b>
Pagat dhe mëditjet	1,120,022	1,105,842	1,105,510	1,127,520	993,287
Mallrat dhe shërbimet	324,960	330,143	324,150	356,913	253,313
Komunalitë	31,000	32,471	31,977	31,000	30,178
Subvencionet dhe transferet	40,000	60,000	55,490	25,800	27,834
Investimet Kapitale	190,421	235,486	202,399	646,160	661,973

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për Paga dhe Mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 014,18€. Fillimisht me rishikim të buxhetit ishte rritur për 28,864€ ndërsa me vendime ishte zvogëluar për 43,044€. Shpenzimet ishin 100% e buxhetit;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 5,183€. Kjo rritje ishte prej huamarrjes 5,166€ dhe donacioneve për 17€. Shpenzimet ishin 98% e buxhetit;
- Buxheti final për komunalitë krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,471€, e të cilat ishin prej të hyrave vetanake të barturanga viti i kaluar. Shpenzimet ishin 98% e buxhetit;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 20,000€ me rishikim të buxhetit. Shpenzimet ishin 92% e buxhetit; dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 45,065€. Kjo rritje ishte prej të hyrave vetanake të bartura 44,974€ dhe donacioneve për 90€. Shpenzimet ishin 86% e buxhetit.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga 2021 ishin në vlerë 63,161€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga taksat për ushtrim të veprimtarisë, të hyrat nga shitja e shërbimeve dhe shfrytëzimi i hapësirave publike etj.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>56,934</b>	<b>56,934</b>	<b>63,161</b>	<b>51,622</b>	<b>60,688</b>
Të hyrat tatimore	33,276	33,276	31,035	23,833	26,753
Të hyrat jo tatimore	23,658	23,658	32,127	27,789	33,936

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 të Komunës së Mamushës ka rezultuar në 4 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, dy (2) ishin zbatuar dhe dy (2) nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**






Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari i komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që kërkesat të planifikohen dhe kategorizohen sipas ndarjes adekuate të buxhetit. Nëse projeksionet e buxhetuara me ligj të buxhetit nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e komunës, duhet të bëhet ridestini i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve. Kjo duhet të reflektoj në përpjekjen për buxhetimin e kërkesave në kategoritë përkatëse ekonomike dhe fuqizimin e kontrollit për pagesën, evidentimin dhe prezantimin e drejt të shpenzimeve publike në PFV.	Nuk kemi verejtur pagesa të ngjashme.	I zbatuar
2.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se komisionet e pranimit dhe menaxherët e kontratave aplikojnë kontrole efektive me rastin e pranimit të punëve/furnizimeve dhe se pagesat bëhen vetëm për punët/furnizimet e realizuara në përputhje me kontratën.	Nuk kemi verejtur çështje të ngjashme.	I zbatuar
3.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se është vendosur një proces efektiv i regjistrimit të pasurisë në mënyrë që regjistrat të jenë të plotë dhe të paraqesin informata të sakta me qëllim të raportimit të drejt dhe menaxhimit adekuat të pasurisë që komuna ka në posedim. Kryetari, po ashtu duhet të siguroj bashkëpunim të ngushtë ndërmjet zyrtarit të pasurisë dhe komisionit të inventarizimit, për harmonizimin e raportit të inventarizimit dhe regjistrave kontabël dhe komisionet e vlerësimit të krijohen në kohën e duhur me qëllim që gjendja e saktë e pasurisë të pasqyrohet drejt në PFV.	Edhe këtë vit kemi identifikuar mos regjistrim të aseteve.	Nuk ka filluar zbatimi
4.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë shërbimin e auditimit të brendshëm, që synon shtimin e vlerës dhe përmirësimin e funksionimit të Komunës, që ndihmon në përmbushjen e objektivave, duke ofruar qasje sistematike, të disiplinuar, për të vlerësuar dhe përmirësuar efektshmërinë e proceseve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes	Ende këtë nuk ishte kryer auditimi i brendshëm	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Shehrije Shala, Drejtore e Auditimit



Etika Co shpk, (Fatmir Mehmeti person i autorizuar në emër të kompanisë)



## Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës

Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Republika e Kosovës - Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova - Republic of Kosovo	
Mamuša Belediyesi - Komuna e Mamushës Opština Mamuša - Municipality of Mamusa	
Çikis - Dalëse - Izlazna - Outgoing	
No.Nr.	02 129 - 22
Tarih/Dt.	07.06.2022

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Mamushës, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

*Per Haxhiu*

Data: 07 Qershor 2022

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>5</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>6</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

## Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

### Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.